

DEKLARATA

E PRIVATËSISË GJATË KRYERJES SË MBIKËQYRJES ME VIDEO

Kjo Deklaratë e Privatësisë shpjegon llojin e të dhënave personale që Shoqëria Financiare FINMAK SHPK Shkup (në tekstin e mëtejshëm: Kontrollori) i mbledh nga Ju gjatë vizitës së hapësirave zyrtare/afariste dhe si Kontrollor i përdor këto të dhëna.

1. Pse mbledhim (përpunojmë) të dhëna personale?

Kontrollori mbledh të dhëna personale përmes sistemit të mbikëqyrjes me video për arsyt (qëllimet) në vijim:

- për të kontrolluar qasjen në objektin (ndërtesën, hyrjen, hapësirat...) dhe për të siguruar sigurinë e objektit, sigurinë e punonjësve në Kontrollorin dhe vizitorët, si dhe pronën dhe informacionin që ndodhen ose ruhen në këto hapësira;
- për të parandaluar, për të penguar, dhe nëse është e nevojshme për të hetuar një qasje të pa autorizuar fizike, duke përfshirë qasjen e pa autorizuar në hapësirat e sigurisë dhe të mbrojtura, infrastrukturën TI apo informacionin operativ dhe
- për të parandaluar, zbuluar dhe hetuar një vjedhje të pajisjes apo mjeteve në pronësi të Kontrollorit, vizitorëve ose punonjësve, ose kërcënime të sigurisë së personelit që punon në hapësirat (për shembull: zjarr, sulm fizik).

Sistemi i mbikëqyrjes me video nuk përdoret për asnjë qëllim tjetër, si për shembull për të ndjekur punën e punonjësve ose praninë e tyre. Video-kamerat janë të vendosura në atë mënyrë që nuk mbulojnë hapësirën publike përreth. Kamerat kanë për qëllim të japin një pasqyrë të përgjithshme të asaj që ndodh në vende të caktuara, por jo edhe për të njohur personat.

Sistemi i mbikëqyrjes me video gjithashtu nuk përdoret si mjet hetimi ose për të marrë dëshmi gjatë hetimeve të brendshme ose procedurave disiplinore, përveç nëse është në pyetje një incident i sigurisë për të cilin është vendosur mbikëqyrja me video në përputhje me Ligjin e Mbrojtjes së Të Dhënave Personale. (Në rrethana të jashtëzakonshme, të dhënat mund të transferohen te organet hetuese në kuadër të një hetimi formal disiplinor ose penal).

Kamerat e mbikëqyrjes me video instalohen në hyrje dhe janë të vendosura dhe të përqendruara ashtu që regjistrojnë vetëm personat që i qasen hapësirave zyrtare/afariste (objekteve), duke përfshirë dhe pronën (për shembull të parkimit).

Sistemi i mbikëqyrjes me video mbulon: vendet hyrëse dhe dalje të ndërtesës, ambientet brenda objektit dhe sipërfaqet e jashtme përreth objektit/ndërtesës.

2. Çfarë të dhënash mbledh Kontrollori?

Kontrollori mbledh vetëm fotografi të kapura nga kamerat, me ç'rast nuk kryhet një regjistrim i zërit.

3. Kush është përgjegjës për përpunimin e të dhënave?

Kontrollori është subjekt që kryen përpunimin e të dhënave personale dhe përcakton qëllimet e përpunimit, vetëm në përputhje me Ligjin e Mbrojtjes së Të Dhënave Personale. Përveç kësaj, punonjësi Lubomir Shubara është personi i kontaktit dhe përgjegjës i mbikëqyrjes me video.

4. Cila është baza juridike e përpunimit të të dhënave personale përmes sistemit të mbikëqyrjes me video?

Kontrollori përdor pajisje të mbikëqyrjes me video për:

- mbrojtjen e jetës ose shëndetit të njerëzve;
- mbrojtjen e pronës;
- mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të punonjësve për shkak të natyrës së punës ose
- sigurimin e kontrollit mbi hyrjen dhe daljen nga hapësirat zyrtare ose afariste.

Prandaj, përpunimi është ligjor në përputhje me nenin 90 të Ligjit të Mbrojtjes së Të Dhënave Personale.

Përveç kësaj, në hyrjen e filialeve, të regjistruara në përputhje me Ligjin e Shoqërive Tregtare, është theksuar dukshëm dhe qartë njoftimi për mbikëqyrjen me video që u mundëson subjekteve të të dhënave personale që të njihen me kryerjen e mbikëqyrjes me video, si dhe për emrin e Kontrollorit që kryen mbikëqyrjen me video dhe për mënyrën në të cilën mund të merret informacion për atë se ku dhe sa kohë ruhen regjistrimet e sistemit të mbikëqyrjes me video.

5. Kush mund t'i shohë të dhënat e mia personale?

Në video-regjistrimet mund të kenë qasje vetëm personat e autorizuar për mbikëqyrje me video (për shembull: anëtarët e personelit të sigurisë së Kontrollorit ose të Agjencisë së angazhuar të sigurimit të privatësisë). Qasja në pajisjen digjitale ose në diskun në të cilin ruhen video-regjistrimet është e kufizuar, e mbrojtur duke aplikuar masa teknike të sigurisë së të dhënave (fjalëkalim, regjistrim për çdo ngjarje ose aksion të punonjësve, gjegjësisht personave të autorizuar). Në të dhënat, gjegjësisht në video-regjistrimet nuk mund të qaset pa autorizimin e Kontrollorit.

6. Si të kontrolloni të dhënat Tuaja?

Mund të dërgoni kërkesë në adresën e e-mail-it të Kontrollorit info@bongo.mk ose në adresën rr. Filipi i Dytë i Maqedonisë nr. 3 Shkup.

7. A mund të kem qasje në të dhënat e mia?

Ju keni të drejtë t'u qaseni të dhënave Tuaja në çdo kohë dhe falas, duke i dërguar një kërkesë kontrollorit ose përmes postës elektronike në: info@bongo.mk.

8. A mund t'i ndryshoj të dhënat e mia?

Nuk është i lejuar ndryshim i video-regjistrimit për mbikëqyrjen me video.

9. A mund të kërkoj kufizimin e përpunimit të të dhënave të mia?

Ju keni të drejtë të kufizoni përpunimin e të dhënave Tuaja personale në çdo kohë duke dërguar kërkesë në adresën e e-mail-it të Kontrollorit info@bongo.mk ose në adresën rr. Filipi i Dytë i Maqedonisë nr. 3 Shkup, kur kontestoni saktësinë e të dhënave Tuaja personale, ose kur Kontrollorit tanimë nuk i janë të nevojshme të dhënat për kryerjen e detyrave të tij. Ju gjithashtu mund të bllokoni përpunimin kur puna është joligjore dhe ju kundërshtoni fshirjen e të dhënave. Megjithatë, bllokimi nuk është i mundshëm në rast të një hetimi zyrtar.

10. A mund t'i fshij të dhënat e mia?

Ju keni të drejtë të fshini të dhënat Tuaja në çdo kohë duke dërguar një kërkesë në adresën e e-mail-it të Kontrollorit info@bongo.mk ose në adresën rr. Filipi i Dytë i Maqedonisë nr. 3 Shkup, kur përpunimi është joligjor.

11. A ndahen të dhënat e mira me persona të tjerë?

Të dhënat Tuaja ruhen tek Kontrollori, përveç nëse nuk kërkonti nga Kontrollori apo nëse jepni pëlqim që ato të ndahen. Në rast të ndarjes së të dhënave Tuaja me palë të treta, do të njoftoheni kujt i janë zbuluar ato, për çfarë qëllimi dhe në çfarë baze ligjore.

12. A kam të drejtë të ankohem?

Po, keni të drejtë të ankoheni dhe të kundërshtoni përpunimin në çdo kohë duke dërguar një kërkesë në adresën e e-mail-it të Kontrollorit info@bongo.mk ose në adresën rr. Filipi i Dytë i Maqedonisë nr. 3 Shkup, kur keni arsye legjitime në lidhje me situatën Tuaj konkrete. Kontrollori do të veprojë sipas kërkesës Suaj brenda 15 ditëve nga dita e parashtrimit të kërkesës.

13. Çfarë mund të bëj në rast të një problemi?

a) Hapi i parë është të informoni Kontrollorin duke dërguar një postë elektronike info@bongo.mk dhe të kërkonti që të ndërmerr veprim.

b) Hapi i dytë, nëse nuk merrni përgjigje nga ne ose nuk jeni të kënaqur nga ajo, kontaktojeni Zyrtarin tonë të Mbrojtjes së Të Dhënave Personale në info@bongo.mk

c) Në çdo kohë mund të parashtroni kërkesë te Agjencia e Mbrojtjes së Të Dhënave Personale www.azlp.mk, e cila do të veprojë sipas kërkesës suaj dhe do të merr masat e nevojshme.

14. Kur fillon përpunimi i të dhënave të mia personale përmes sistemit të mbikëqyrjes me video?

Përpunimi fillon në momentin kur vizitoni hapësirat e Kontrollorit.

15. Siguria e të dhënave personale

K Kontrollori është i përkushtuar për mbrojtjen e të dhënave personale. Prandaj, përdor teknologji dhe procedura të sigurisë me të cilat mbrohen të dhënat Tuaja personale para së gjithash nga një qasje, përdorim ose zbulim i pa autorizuar. Ne i ruajmë të dhënat Tuaja në sisteme kompjuterike me qasje të kufizuar dhe në ambient të kontrolluar.

16. Sa kohë i ruajmë të dhënat Tuaja?

Kontrollori do të ruajë të dhënat Tuaja personale 30 (tridhjetë) ditë kalendarike pas vizitës Suaj në hapësirat tona, pas së cilës të gjitha video-regjistrimet e regjistruara fshihen në mënyrë automatike.